



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 2.3.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Doruntinë Maloku.

Munguan: Fatmir Limaj, Nezir Çoçaj, Melihate Tërmerkollli dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sami Kurteshi, Institucioni i Avokatit të Popullit; Suzana Gashi, IAP; Basri Berisha, IAP; Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Avni Bytyçi, GLPS; Tienmu Ma, IAP; Blerta Bejtullahu EUSR; Valentina Demolli, KMDL NJ; Liridon Sadiku, IKPZH; Ardian Bajraktari, MD; Dona Lluka, Radio Dukagjini; Sylë Ahmeti, Kosova Sot; Floriana Shehu, OSBE; Qendrim Imeri, Infodirekt.tv; Beadin Sylja, Kosovapress; Dibran Istrefi Klan Kosova; Burim Xhemajli, Tribuna; Valmir Klaiqi, Top Chanel; Fitore Hajdini- Berisha, ZPRK; Florina Merovci, ZPRK; Agim Sulaj, Lajmi.net; Gita Lushi, Rrokum TV; Blerta Aliu, Koha Ditore; Ilir Krasniqi, Kosova.info .

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 30.1 dhe 6.2.2015;

3. Diskutim me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese dhe Avokatit të Popullit lidhur me nismën e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 30.1 dhe 6.2.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 30.1 dhe 6.2.2015, pa vërejtje.

3. Diskutim me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese dhe Avokatit të Popullit lidhur me nismën e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetarja, theksoi se pavarësisht që ftesa është dërguar për të dy palët, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Gjykatën Kushtetuese, për të marrë pjesë në diskutimin në lidhje me Rekomandimin e Avokatit të Popullit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, përfaqësuesit e Gjykatës nuk kanë gjetur vullnetin që të vijnë dhe i konsideroi si të papërgjegjshëm karshi Kuvendit dhe deputetëve. Ajo falënderoi Institucionin e Avokatit të Popullit për pjesëmarrjen në mbledhje. Pasi konstatoi bazën ligjore mbi të cilën Avokati i Popullit ka bërë Rekomandimin dhe ka të drejtën e nismës legislative dhe të drejtën për të paraqitur çështje pranë Komisionit për Legjislacion, ajo theksoi se në kuadër të kompetencës së Komisionit, është paraparë ndryshimi i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Ajo theksoi se qëllim i takimit të sotëm është informimi i detajuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me Rekomandimin e shtruar në Komision për diskutim. Më pas, fjalën ia dha z.Sami Kurteshi, Avokat i Popullit, për të dhënë sqarimet në emër të institucionit që përfaqëson, për Rekomandimin e sjellë.

Sami Kurteshi, përshëndeti të pranishmit, si dhe falënderoi në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit kryetaren, deputetët dhe të gjithë të pranishmit për kohën e ndarë për diskutimin në lidhje me Rekomandimin. Ai theksoi se që nga viti i kaluar është përgatitur një raport nga ana e institucionit të tij, po që për arsye të mosfunksionimit të Kuvendit ka mbetur pa u sjellë në Kuvend deri më tani, raport që ka të bëjë me ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht nenit 30 të tij. Diskutimi ka të bëjë me afatin kohor që përcakton ky nen, që Avokati i Popullit, brenda gjashtë muajve, mund të kontestojë për kundërkushtetutshmëri aktet ligjore. Sipas tij, ky kufizim kohor është joproporcional, në kundërshtim me përvojat e vendeve të rajonit që kanë ngjashmëri politiko-juridike me vendin tonë dhe në kundërshtim me përvojat e vendeve evropiane. Arsye kryesore për të ngritur këtë çështje ka qenë përvoja e Kosovës dhe e Institucionit të Avokatit të Popullit, andaj e kemi konsideruar si të domosdoshme procedurën për ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e në këtë rrjedhë, amendamentimin e nenit 30 të

këtij ligji, ku kërkojmë që të hiqet tërësisht kufizimi kohor për Avokatit të Popullit, kjo sepse në kemi kompetencë që të rekomandojmë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend apo ndryshimin e ligjeve ekzistuese, ose ndryshimin apo nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, prandaj ne kemi zhvilluar hulumtime ligjore për çështjen në fjalë. Duhet theksuar se e drejta e Avokatit të Popullit për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese nuk është e kufizuar në aspektin material, pra në substancë, por ajo është e kufizuar vetëm proceduralisht, pra me kufizimin gjashtëmuajor, dhe jo vetëm Avokati i Popullit e ka këtë kufizim, por edhe institucionet e tjera e kanë atë, prandaj ne kemi tentuar që përmes këtij raporti që përmban një analizë ligjore, pas një hulumtimi të një vargu të madh kushtetues të vendeve të ndryshme, jo vetëm rajonale, (ku mori shembull disa shtete të ndryshme) të argumentojmë konstatime të caktuara nga ana jonë: Kosova ka një infrastrukturë shumë të re ligjore relativisht solide mirëpo, zbatimi i tyre mund të jetë i ngadalshëm. Prandaj, shkeljet e mundshme të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut mund të shpërfaqen pasi afati për ngritjen e rasteve të kushtetutshmërisë së ligjit-afati normativ të ketë kaluar. Kosova edhe pse është një vend i ri, nuk mund t'i lejojë vetes që të ketë një ligj që nuk është në përputhje as me standardet ndërkombëtare, as me Kushtetutën, si dhe me përvojën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Më tutje: GJEDNJ). Ne kemi një gjetje te GJEDNJ-së ku këtë kufizim që e kanë ombudsman-ët, e quan si të paarsyeshëm, pa ndonjë logjikë. Avokati i Popullit është i vetmi institucion që sipas Kushtetutës së Kosovës ka të drejtë të referojë në Gjykatën Kushtetuese çështje pa asnjë kufizim material për të gjitha çështjet, mirëpo Ligji për Gjykatën Kushtetuese parasheh një afat kohor prej gjashtë muajsh për ngritjen e rasteve për kushtetutshmëri, gjë që paraqet një kufizim procedural, që është dëshmuar se nuk është i qëndrueshëm. Duke qenë se GJEDNJ, në një rast të saj, ka theksuar se dukuritë shoqërore, ligjore dhe kushtetuese brenda një shteti, janë gjithmonë në proces dinamik, pra të ndryshimit, dhe se gjithmonë duhet nxjerrë ligje të reja, apo të bëhet amendamenti i tyre. Ky kufizim do të rrezikojë të jetë një pengesë për reformë dhe përmirësim. Në mënyrë që Republika e Kosovës t'i përgjigjet ndryshimit të standardeve ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut, afati gjashtëmuajor për referim në Gjykatën Kushtetuese nga ana e Avokatit të Popullit, duhet të hiqet. Prandaj, duke u nisur nga këto fakte dhe dëshmi, Avokati i Popullit rekomandon: 1. Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nr. 03/L-121, përkatësisht të nenit 30, duke e hequr tërësisht kufizimin kohor për kundërshtimin e akteve juridike nga Avokati i Popullit. 2. Neni 30 i ligjit të riformulohet si vijon: “Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji mund të parashtrohet në çdo kohë pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar”. Edhe një arsye shtesë për t'u larguar ky kufizim është fakti se ka shumë ligje që nuk hyjnë në fuqi atëherë kur miratohen, por vet ligji parasheh situata që fuqia e tij fitohet pas një afati të caktuar kohor (p.sh. pas 2 viteve), prandaj me kalimin e afatit prej gjashtë muajsh, në rast se ligji ka mangësi, nuk do të jetë e mundur që të atakohet në Gjykatën Kushtetuese.

Kryetarja, theksoi se do të ishte shumë më mirë sikur të ishin prezent edhe përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese, por duke e marrë parasysh skandalin me falsifikimin e kuorumit, është e pritshme mungesa e tyre. Ajo theksoi se nisma e Avokatit të Popullit për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, është plotësisht në përputhje me praktikën evropiane. Ajo konsideroi se kur të shkelen të drejtat e njeriut, me këtë afat kohor, nuk do të ketë mundësi referimi në Gjykatën Kushtetuese.

Armend Zemaj – theksoi se kërkesa e Avokatit të Popullit ka një arsye që bazohet në punën e këtij institucioni. Ai tha se Kuvendi nuk është i interesuar që të nxjerrë ligje që janë kundërkushtetuese, por dhe nuk dëshiron të lejojë situata të cilat mund t'i ndeshin dy institucione njëra me tjetrën. Ai theksoi se afati prej gjashtë muajsh është një afat solid, duke marrë si shembull kohën të cilën merr një ligj deri sa të hyjë në fuqi, përgatitja dhe debatet rreth tij, ku ka mundësi që të hetohet nëse ligji është në kundërshtim me Kushtetutën. Por, propozimi nga Zyra e Avokatit të Popullit është një qasje konstruktive edhe në raport me Gjykatën Kushtetuese. Ai theksoi se është mirë që të studiohet kjo procedurë, por nëse Avokati i Popullit arrin të na bindë ne se ky ndryshim i ndihmon zhvillimit të demokracisë në vend, nuk i komplikon procedurat, nuk do të ishte pengesë nga ana jonë që ta japim një mendim pozitiv ose negativ. Ai parashtroi pyetje për Avokatin e Popullit: Cilat kanë qenë pengesat që janë krijuar nga kjo situatë dhe a ka pasur ndonjë rast ku ai është penguar ta ushtrojë detyrën e tij kushtetuese si rezultat i këtij kufizimi? Nëse ka pasur ndonjë pengesë, atëherë ne jemi të interesuar për të zhvilluar këtë çështje.

Kryetarja, theksoi se kur jemi te ndryshimi që po rekomandon Avokati i Popullit, ai ndryshim ka të bëjë vetëm me largimin e kufizimit kohor për këtë institucion, sepse këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë ndryshim sa i përket subjekteve të tjera të autorizuar për të ngritë çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kur jemi këtu, ne si Komision i kemi kërkuar Drejtorisë për Hulumtime këtu në Kuvend që të bëjë një studim më të detajuar në lidhje me çështjen në fjalë dhe ta njoftojë Komisionin.

Selviqe Halimi, theksoi se deri më tash nuk kemi pasur ndonjë informatë që ky kufizim ka penguar ngritjen e ndonjë rasti për kundër-kushtetutshmëri. Nisma nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit është e mirëpritur, edhe nëse nuk ka pasur pengesa deri më tani nga ky kufizim, me vet faktin që kjo çështje është ngritur dhe kjo i shërben demokracisë në vend, ndërsa për Komisionin nuk paraqet problem trajtimi i saj. Ajo shtroi pyetjen se a ka ndodhur që deri tash ndonjë ligj i cili është aprovuar në Kuvendin e Kosovës të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. A ka pasur ndonjë dekret ose akt tjetër nënligjor që ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën, pra a ka pasur raste kur ky kufizim kohor e ka penguar Avokatin e Popullit ta ushtrojë funksionin e tij? Gjithashtu, ajo pyeti edhe në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e statuteve të komunave, juridiksion i cili buron nga neni 113.2, ku edhe Avokati i Popullit është palë e autorizuar për ngritjen e kësaj çështjeje, se a ka pasur raste kur statuti i ndonjë komune ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën e vendit.

Kryetarja, theksoi se ka dy ligje të cilat i ka miratuar Kuvendi, i ka dekretuar Presidentja, ato ligje janë: Ligji për Amnistinë dhe, Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, ku nenet e këtyre ligjeve, Gjykata Kushtetuese i ka shpallë në kundërshtim me kushtetutën, dhe rrjedhimisht i ka shfuqizuar, por ka raste që Gjykata Kushtetuese nuk ka dashur të lëshohet në vlerësim

kushtetues, siç është rasti i Marrëveshjes Thaçi-Daçiç, por kur duke e ditur se Gjykata Kushtetuese është e “kapur”, edhe mund të presim vendime të tilla.

Agim Aliu, tha se Ligji për Gjykatën Kushtetuese kur është nxjerrë në vitin 2008, ka paraparë që përmes tij të realizohen të drejta të caktuara. Por, duke e pasur parasysh që kanë kaluar shtatë vite që nga koha e nxjerrjes së tij, kanë mundur të paraqiten situata faktike, probleme të ndryshme me ç’rast ndonjë çështje e caktuar ka mundur të mos gjejë udhëzgjidhjen. Ajo çka do të dëshiroja ta dijë është se nga koha e nxjerrjes së ligjit e deri më tani, sa është dëmtuar interesi publik dhe liritë dhe të drejtat e njeriut, duke e pasur parasysh kufizimin kohor prej gjashtë muajsh të shprehur me ligj. Nëse ka pasur raste të cenimit të interesit publik dhe lirive dhe të drejtave themelore, ne do të mbështesim një nismë të tillë, ngase edhe ne si deputetë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës, jemi që të mbrohet ai interes publik. Pra, në rast se ekziston një shkelje e tillë, do të ishte mirë që ajo të përfshihet në raportin nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Agim Ademaj, theksoi se është e rëndësishme të dihet motivi i vendosjes së këtij afati nga ana e ligjvënësit. Avokati i Popullit e shpjegoi motivin e nismës së këtij ndryshimi, por dilema është se a ia vlen të hiqet ky kufizim në mënyrë të tërësishme apo duhet lënë një afat kohor kufizues. Kjo sepse, nëse hiqet tërësisht kufizimi, kam frikën se më pastaj Avokati i Popullit dhe stafi tij do të jenë më neglizhues në punën e tyre dhe konsideroj se kjo ka qenë edhe motivi për vendosjen e këtij afati gjashtëmuor. Ne nuk duhet të ngutemi me këto nisma për ndryshime dhe plotësime, por presim nga ana e Avokatit të Popullit që ta arsyetojë në mënyrë bindëse se kur ky kufizim ka prodhuar ngecje në punën e tij dhe vlerësimin për kushtetutshmëri të akteve ligjore.

Sami Kurteshi, theksoi se pyetjet ishin të rëndësishme dhe se mundësojnë të theksojmë esencën e kërkesës. Esenca e kërkesës është që në çdo kohë kur përvoja dëshmon në Kosovë se një normë pas fillimit të zbatimit të saj është në kundërshtim me Kushtetutën, do të duhej të ndryshohej. Meqenëse ligjet dhe Kushtetuta duhet të jenë instrument që vazhdimisht ndryshon, evoluon dhe se mendojmë se do të na duhet që pas 10 vitesh, të ndryshojmë ligje ekzistuese. Në pyetjen e z. Zemaj se a ka raste nga përvoja, konsideroj se është e rëndësishme të thuhet që po, kemi raste nga përvoja. Ka raste kur është refuzuar kërkesa për shkak të tejkalimit të afatit prej gjashtë muajsh, kemi raste kur ne kemi pranuar kërkesa sidomos nga shoqëria civile se është tejkaluar afati, si dhe kemi raste të cilat i kemi parë, i dimë, por nuk do të kemi mundësi t’i dërgojmë, e sidomos është Ligji për veteranët, që qysh tash i kemi hetuar shkeljet që janë në ligj, që është kundërkushtetues, por nuk do të mund ta dërgojmë për arsye se kanë kaluar gjashtë muaj. Ne kemi përgatitur një raport për ngjarjet që kanë ndodhur kohëve të fundit në Universitetin e Prishtinës për rastet e regjistrimit të studentëve, dhe qysh në fillim, kemi parë që ligji është kundërkushtetues. Znj. Halimi the se a ka pasur raste të shkelura, po, pra, kjo është, ka pasur raste dhe se kjo as nuk lidhet me Gjykatën Kushtetuese, e as me Kuvendin, por lidhet me nevojën tonë për të shndërruar legjislacionin tonë në legjislacion dinamik, pra që legjislacioni

ynë të përshtatet me ndryshimet dhe rrethanat shoqërore, si dhe me ndryshimet që ndodhin në legjislacionin ndërkombëtar. Kjo përbën edhe thelbin e kërkesës tonë. Sa i përket praktikës, Gjykata Kushtetuese ka ditur që në rastet kur çështjen e ka ngritur Qeveria apo Presidenti i Republikës, t'i ikë këtyre afateve, ndërsa kur ka qenë çështja tek Avokati i Popullit, ajo ka qëndruar shumë konservatore, duke aluduar se afati është rregull ligjore që nuk tejkalohet. Në pyetjen se sa është penguar puna e Avokatit të Popullit si pasojë e këtij afati, ne mund të themi se nuk është penguar, ngase nuk është mundur fare të dërgohet rasti dhe për rrjedhojë ligji mbetet i keq. Në pyetjen se a është bërë ndonjë studim se a janë statutet e komunave në përputhje me Kushtetutën, mund të themi se ne nuk kemi kapacitet në institucion për hulumtimin e të gjitha statuteve të komunave dhe të gjitha ligjeve të miratuara që nga viti 2008, se a janë në kundërshtim me Kushtetutën. Në pyetjen e z.Aliu se a është dëmtuar interesi publik, mund të themi, po, ngase rastet që nuk kemi mundur t'i ngremë ose i kemi ngritur, na janë refuzuar, kanë pasur lidhje në instancë të fundit me interesin publik. Në pyetjen e z.Ademaj se cili ka qenë motivi i këtij kufizimi, realisht ne vetëm mund të supozojmë për këtë, ngase ne nuk kemi qenë pjesë përbërëse e ndonjë grupi punues kur është shkruar ligji, por, në vendet tjera, në raste të ngjashme, kufizimi mendohet në ngarkesën e pranuesit e jo në neglizhencën nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit. Ne duhet shikuar se kufizimi a është proporcional, a ka ndonjë qëllim të caktuar, a arsyetohet qëllimi, a ka ndonjë mjet tjetër që këto kufizime të tejkalohen dhe cilat janë ato mjete, dhe në fund fare, cili do të ishte mjeti për ndryshimin e saj. Dhe pas tërë kësaj analize, ne kemi arritur në përfundim se e vetmja gjë që duhet të ndryshohet është ndryshimi i këtij kufizimi, heqja e tij, sepse Kosova e ka për detyrë jo për hir të ndërkombëtarëve, por për që të ketë mundësi që çdo mangësi në ligje ta largojë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se kjo çështje do të diskutohet edhe në një takim të radhës, pasi të kemi edhe një hulumtim nga Drejtoria për Hulumtime e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

Kryetarja, tha se e kemi marrë propozimin nga Ministria e Drejtësisë për emrat e të propozuarve për anëtarë të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës. Emrat janë: Fejzullah Hasani, Rexhep Gashi (është tërhequr, ngase i njëjti është propozuar anëtar në Institutin Gjyqësor të Kosovës), Abdullah Aliu, Adem Vokshi, Ilaz Ramajli, Robert Muharremi, Ivan Çukaloviq, Asllan Bilalli, Mirlinda Batalli, Rafet Haxhaj.

Armend Zemaj, theksoi se nuk kemi diçka konkrete për të thënë, sepse dihet se nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në propozime, përveç nëse të njëjtit nuk i plotësojnë kushtet, por me sa kujtoj unë, të gjithë i përmbushin ato, janë emra të njohur, por nëse dëshironi ta shtyjmë si pasojë e plotësimit edhe me një anëtar, atë mund ta bëjmë, përndryshe gjithçka më duket në rregull.

Kryetarja, Nëse i analizojmë emrat që janë propozuar pranë Komisionit për Legjislacion, vërejmë se disa nga emrat që unë nuk po i përmendi, nuk e përmbushin këtë kriter, e që është kriteri kryesor për të qenë anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, andaj kërkoj përkrahjen tuaj, që ne, këtë propozim, t'ia rikthejmë në shqyrtim Ministrisë së Drejtësisë dhe të kërkojmë nga ata që të respektojnë nenin 4 të Ligjit për provimin e jurisprudencës. Konsideroj se është e padrejtë që ne t'i adresohemi Kuvendit, duke bërë shkelje të ligjit, pra duke u votuar këta persona nga Kuvendi. Obligimi ynë është që të përkujdesemi për kriteret që i ka vendosur Ligji për provimin e jurisprudencës dhe unë kam analizuar së bashku me administratën e Kuvendit, të gjithë anëtarët dhe përvojën e tyre të punës dhe kemi vlerësuar se disa prej tyre nuk i plotësojnë kushtet që i parasheh Ligjin për provimin e jurisprudencës.

Armend Zemaj, theksoi se në kohën kur është punuar dhe ka hyrë në fuqi ligji, ne kemi qenë prezent, dhe në fakt është menduar se ky ligj ka qenë më shumë tranzitor, sepse është thënë se do të themelohet Akademia e Drejtësisë dhe është menduar të jetë për një fazë dyvjeçare, mësa mbaj mend, por kam dëgjuar se së shpejti do ta kemi Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe kjo do të rregullohet. Unë mendoj se gjeneratat e reja kanë nevojë dhe atë çka ne po e kërkojmë, reformimin e sistemit të drejtësisë, mos të kemi tash kufizime, ngase shtyrja e këtij procesi do ta shtynte edhe afatin e provimit. Pothuajse shumica e tyre kanë qenë edhe më herët në këtë Komision. Të gjithë janë të nivelit akademik dhe besoj se nuk duhet të kemi tash kufizime, por unë mendoj se ne mund ta shtyjmë vetëm nëse dëshironi për hir të zëvendësit, por as këtë nuk do ta bëja, sepse mendoj se duhet t'i procedojmë për seancë plenare, pavarësisht se duhet ta ngrini këtë dilemë se mos nuk e kanë të dhënë provimin e jurisprudencës.

Kryetarja, i ngriti disa çështje për diskutim. Theksoi se edhe ajo është dakord që studentët sa më parë t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës dhe konsideroi se është e rëndësishme që Komisioni për Legjislacion t'i zgjedhë anëtarët e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Sa i përket Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, kam dëgjuar se ai ka të bëjë me shndërrimin e Institutit Gjyqësor në Akademi dhe se nuk e di a do ta ketë kompetencën e mbajtjes së provimit të jurisprudencës ai institucion. Për sa kohë që është në fuqi Ligji për provimin e jurisprudencës, konsideroj se nuk kemi asnjë të drejtë që ta shkelim këtë ligj, përkatësisht këtë paragraf. E kam të qartë që anëtarët e propozuar janë ekspert të mirë, kanë përvojë të mirë, por është kufizimi prej 12 vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë që i bënë të padenjë. Për mendimin tim, ky kufizim është i tepërt. Por, unë nuk mund ta nënshkruaj një rekomandim që shkel Ligjin për provimin e jurisprudencës. Unë kërkoj që ta kem mbështetjen e anëtarëve të Komisionit, që t'ia rikthejmë këta emra Ministrisë së Drejtësisë dhe t'i sjellë në përputhje me nenin 4 të Ligjit për provimin e jurisprudencës.

Selvije Halimi, theksoi se i duket i çuditshëm fakti se si është lënë një normë e tillë që përfshin kriterin 12 vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë në Kosovë, ku ne kemi vetëm 15 vjet që nga

paslufta. Kriteri se të jetë ekspert i drejtësisë, më duket relativ për faktin se kush e vlerëson se një kandidat është i tillë. Andaj, konsideroj se në bazë të këtyre kriterëve, do të jetë e pamundur që të gjinden njerëz me kualifikim adekuat në Kosovë. Duke e pasur parasysh këtë situatë ose e procedojmë për ndryshim ligjin me një procedurë të përshpejtuar dhe me një kërkim falje nga ana e studentëve, ose i procedojmë këta emra.

Kryetarja, theksoi se procedura e përshpejtuar për ta bërë plotësimin dhe ndryshimin e ligjit merr shumë kohë. Unë propozoj që meqë emrat e propozuar nga Ministria e Drejtësisë nuk i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 4 të Ligjit për provimin e jurisprudencës, t'ia rikthejmë në rishqyrtim dhe të kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë që t'i sjellë emrat në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe t'ua bëjë me dije që nuk nënshkruaj asnjë rekomandim që është në kundërshtim me ligjin.

Armend Zemaj – E shoh të arsyeshme që të kërkojmë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, që brenda një jave, nga dita e sotme, t'i shqyrtojë edhe një herë kandidatët, dhe nëse nuk kemi përgjigje, atëherë ta procedojmë me këta emra që i kemi, ngase konsideroj se të gjithë janë profesionistë të fushave, doktorë shkence, kredibilë për të qenë aty.

Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar për kandidatët e propozuar për anëtarë dhe zëvendësanëtarë, Komisioni për Legjislacion konstatoi se disa nga kandidatët e propozuar, nuk i plotësojnë kushtet, sipas ligjit, për të qenë anëtar dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, sipas nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-141.

Lidhur me këtë, Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

- I. *I kthehet Ministrisë së Drejtësisë për rishqyrtim propozim - vendimi për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.*
- II. *Është e nevojshme që Komisionit për Legjislacion, propozimet e kandidatëve për anëtarë dhe zëvendësanëtarë, t'i procedojë më së largu deri më 9.3.2015.*

5. Të ndryshme

Kryetarja, theksoi se ka një çështje për të ngritur sa i përket Këshillit Gjyqësor. Ajo theksoi se Kuvendi në seancë plenare ka votuar një anëtar për t'u zgjedhur në atë institucion, por i njëjti është duke u hetuar për shkelje disiplinore. Unë kam tërhequr vërejtjen që mos ta votojnë, por nuk e kanë marrë parasysh kërkesën time. Armend Berisha e ka pranuar që është nën hetime. Unë konsideroj se ne jemi mashtruar edhe nga ana e Këshillit Gjyqësor, ngase ka thënë që nuk ka gjyqtar që janë duke u hetuar. Unë i kam adresuar një kërkesë Zyrës së Komisionit Disiplinor që

zyrtarisht të më informoj, nëse z.Armend Berisha është duke u hetuar për shkelje disiplinore. Konsideroj se është e rëndësishme që në momentin kur Zyra e Komisionit Disiplinor e konfirmon se ai është duke u hetuar për këtë shkelje, menjëherë ne si Komision të kërkojmë shkarkimin e tij.

Armend Zemaj, theksoi se në lidhje me këtë çështje është mirë të thirret një takim i mbyllur me Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe kryetarin e Këshillit Gjyqësor dhe po këta të na informojnë në lidhje me hetimin dhe shkeljen disiplinore. Dhe kjo të jetë në shërbim të eliminimit të spekulimeve se a ka vendosur Kuvendi drejt në këtë çështje apo jo. Madje, jo vetëm aq, duhet që të kemi informata të sakta se sa gjyqtarë janë duke u hetuar, ngase duket absurde të ndajë drejtësi dikush që është nën hetime.

Në fund, dua të theksoj diçka në lidhje me raportet për seancë plenare, pra në emër të Komisionit, të jetë raporti i Komisionit, sepse herën e fundit ishte përfshirë edhe mendimi juaj, e nëse është kështu, atëherë duhet të përfshihen mendimet e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe të dërgohet si procesverbal, e jo si raport me mendime selektive.

Kryetarja, theksoi se është plotësisht dakord me mendimin e z.Zemaj, se të gjitha mendimet e deputetëve duhet të futën në procesverbal, por në lidhje me rastin e fundit e ka parë si mundësinë e vetme që t'i paraqesë Kuvendit vërejtjen në lidhje me votimin që është bërë aty për çështjen që diskutuam. Sa i përket çështjes së hetimeve disiplinore, ajo theksoi se është e rëndësishme që të merret me seriozitet procesi, dhe po ashtu, u dakordua që të thirret Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe Këshilli Gjyqësor, për të informuar në lidhje me shkeljet disiplinore, në mënyrë që të evitojmë rastet e tilla, duke e pasur parasysh edhe vendimin e Komisionit që nuk mund të emërohet anëtar i Këshillit Gjyqësor askush që është duke u hetuar për shkelje disiplinore.

Selviqe Halimi, theksoi se është e rëndësishme që të kemi parasysh dhe qëllim tonë që të spastrohen çështjet me secilin njeri që Kuvendi i jep përgjegjësi në një institucion të caktuar. Gjithashtu, duhet të bëhet dallimi në mes të hetimit penal dhe atij disiplinor. Por, pavarësisht se në cilën fazë ka arritur ai hetim, a është ende vetëm në kuadër të disiplinës apo ka kaluar në lëmin penal, unë jam për atë që çështja të zbardhet dhe të hiqen dilemat për të gjitha rastet. Sa i përket çështjes së procesverbaleve dhe raporteve, konsideroj se në adresim kur i bëhet Kuvendit, të jenë të theksuara vetëm qëndrimet e Komisionit, ndërsa për mendimet e secilit deputet veç e veç, të dërgohet procesverbali, nëse kjo kërkohet të ndodhë. Dhe për fund, konsideroj se është mirë të bëhet praktikë në Komision që për çdo vendim që marrim për të ftuar dikë për të informuar, apo bashkëbiseduar, ajo të behët një javë para se të vijë të ftuarit. Dhe një kërkesë tjetër që kryetarja dhe nënkryetarët të hartojnë rendin e ditës për mbledhjet e ardhshme, ose nëse kjo paraqet pengesë, këtë ta bëjë Komisioni si tërësi.

Kryetarja, theksoi se sa i përket çështjes së fundit që ngriti znj.Halimi, këtë më së miri e rregullon Rregullorja e Punës së Kuvendit, ku theksohet se mbledhjet i thërret kryetari i

Komisionit dhe ai e cakton rendin e ditës, ose në paragrafin 4 thuhet se zëvendëskryetari, në rast mungese të kryetarit.

Selviqe Halimi, theksoi se edhe ajo është e përkushtuar për të respektuar Rregulloren e Kuvendit, por në një rast kur ka tentuar ta thërrasë një mbledhje të Komisionit, kjo i është bërë e pamundur nga ana e kryetares.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
